



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr. 65**

**2003**

**Gusht**

### P Ë R M B A J T J A

|                                | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|--------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ligj nr.9100<br>datë 10.7.2003 | Për ratifikimin e "Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Organizatës për Furnizime dhe Mbështetje e NATO-s (NAMSO) mbi bashkëpunimin për mbështetje logjistike"..... 2889                                                                                   |
| Ligj nr.9103<br>datë 10.7.2003 | Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare..... 2895                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Ligj nr.9104<br>datë 17.7.2003 | Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lidhur me bashkëpunimin në fushën e parandalimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe forcimit të marrëdhënieve ushtarake dhe të mbrojtjes"..... 2903 |
| Ligj nr.9106<br>datë 17.7.2003 | Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë..... 2907                                                                                                                                                                                                                                          |
| Ligj nr.9107<br>datë 17.7.2003 | Për disa ndryshime në ligjin nr.8636, datë 6.7.2000 "Për zonat e lira", ndryshuar me ligjin nr.8725, datë 26.12.2000..... 2919                                                                                                                                                                       |
|                                | Shpallje kërkesë për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të tokës me sipërfaqe 650 m <sup>2</sup> në Bashkinë Ballsh..... 2920                                                                                                                                                                    |
|                                | Shpallje kërkesë për shpronësimin publik të pasurive të paluajtshme për ndërtimin e Urës së Re Bogovë..... 2920                                                                                                                                                                                      |

**L I G J**  
**Nr.9100, datë 10.7.2003**

**PËR RATIFIKIMIN E "MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË  
SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS PËR FURNIZIME DHE  
MBËSHTETJE E NATO-S (NAMSO) MBI BASHKËPUNIMIN PËR MBËSHTETJE  
LOGJISTIKE"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet "Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Organizatës për Furnizime dhe Mbështetje e NATO-s (NAMSO) mbi bashkëpunimin për mbështetje logjistike".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3915, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**MEMORANDUMI**  
**I MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE**  
**ORGANIZATËS PËR MBËSHTETJE LOGJISTIKE TË NATO-S (NAMSO) "MBI**  
**BASHKËPUNIMIN PËR MBËSHTETJE LOGJISTIKE"**

Ky Memorandum mirëkuptimi përbën bazën ligjore në vendosjen e marrëdhënieve logjistike ndërmjet Shqipërisë dhe NAMSO-s të përcaktuar në nenet e mëposhtme.

**HYRJE**

Mbasi:

- Shqipëria ka pranuar ftesën për t'u bashkuar në partneritetin për paqe (PfP) dhe ka firmosur Dokumentin e Partneritetit për Paqe në 23 shkurt 1994 është bërë vend partner në PfP.
- Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë ka shprehur interes në lidhje me shërbimet e ofruara nga NAMSO brenda kuadrit të programeve të saj dhe partneritetit në sistemin e armëve.
- Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë po hyn në negociata me NAMSO-n me synimin e vendosjes së bashkëpunimit në fusha të caktuara të mbështetjes logjistike.
- Bordi i Drejtorëve të NAMSO-s ka rënë dakord të pajisë Shqipërinë me shërbime mbështetëse logjistike (siç janë specifikuar më poshtë).
- Bordi i Drejtorëve të NAMSO-s ka përcaktuar në mënyrë më specifike, në kuadrin e bashkëpunimit me vendin partner të NATO-s, shqetësimin e vendeve të NATO-s për zvogëlimin e shpenzimeve të programeve të NAMSA-s, të cilat janë njëloj për të gjitha vendet anëtare. Kjo përbën një nga objektivat e parashtruara në Kartën e NAMSO-s.
- Këshilli i Atlantikut të Veriut ka paraqitur rekomandimet e Bordit të Drejtorëve të NAMSO-s mbi përfundimin e një marrëveshjeje të mbështetjes me Republikën e Shqipërisë, me mirëkuptimin

se hyrja në marrëveshje të tilla duhet t'i japë Shqipërisë statusin e anëtarësimit në NATO ose t'i japë të drejtën asaj ta kërkojë këtë status.

- Bordi i Drejtorëve të NAMSO-s ka autorizuar Drejtorin e Përgjithshëm të NAMSA-s që të fismosë këtë Memorandum mirëkuptimi;

- Shqipëria dhe NAMSO bëhen pas kësaj "Palë" dhe kanë arritur mirëkuptimin mbi dispozitat e mbështetjes logjistike.

Përkufizime/Shkurtesa

Në tekstin e këtij Memorandumi të mirëkuptimit dhe atë të vendosjes së marrëveshjeve specifike ndodhen këto terma:

- "NATO" nënkupton Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut;

- "NAMSO" nënkupton Organizatën për Furnizim dhe Mbështetje të NATO-s;

- "NAMSA" nënkupton Agjencinë për Furnizime dhe Mbështetje të NATO-s;

- "PfP" nënkupton partneritetin për paqe të institucionalizuar në Samitin e NATO-s në Bruksel, më 10-11 janar 1994;

- "Informacion teknik" nënkupton informacionin e dokumentuar ose të regjistruar me një natyrë teknike ose shkencore, pavarësisht nga formati, tiparet dokumentare ose paraqitja. Ky informacion mund të përfshijë, por duke mos u kufizuar në secilën nga të dhënat e mëposhtme; të dhëna eksperimentale dhe teste, specifikime, projekte dhe procese projekti, shpikje ose zbulime të patentuara ose jo, përshkrime teknike dhe punime të tjera të karakterit teknik, topografi gjysëm përçuese/pune me maska, paketa të dhënash teknike dhe prodhimi dhe sekrete tregtare dhe informacione që lidhen me teknikat industriale. Ky mund të paraqitet në formën e dokumenteve riprodhime me figura, vizatime, paraqitje grafike, si dhe regjistrime filmike ose në disk (optike, manjetike dhe lazer), paraqitje kompjuterike me programe dhe database ose me të dhëna të ruajtura në kompjuter e forma të tjera;

- "W S P" nënkupton partneritet në sistemin e armëve.

Neni 1

### **Qëllimi**

Ky Memorandum mirëkuptimi përcakton një kornizë formale për sigurimin e shërbimeve logjistike në fusha të përcaktuara qartë duke përfshirë, por jo të kufizuara në furnizimet, mirëmbajtjen, prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, transportimin, kontrollin e trajtimit dhe asistencën teknike.

Neni 2

### **Zbatimi**

2.1 Zbatimi i Memorandumi të mirëkuptimit do të kërkojë hartimin e marrëveshjeve specifike me shkrim si marrëveshjet e shitjeve, marrëveshjet e sigurimit të shërbimeve, marrëveshjet për WSP etj.

2.2 Nënkuptoheq që marrëveshjet si ato të paraqitura në paragrafin 2.1 dhe anëtarësimi në WSP mund të kërkojnë miratimin paraprak të Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë dhe atë të Bordit të Drejtorëve në NAMSO-s, si dhe të vendit të origjinës të sistemit të armëve ose pajisjeve të përfshira.

Neni 3

### **Masat financiare**

3.1 Asnjë përgjegjësi financiare nuk do t'i atribuohet ose nuk do të dalë për Palët në këtë Memorandum mirëkuptimi në rast se nuk merret pëlqimi nëpërmjet një marrëveshjeje, siç parashikohet në paragrafin 2.1, ku trajtohet fusha e veçantë e veprimtarisë dhe e detyrës.

3.2 Është e kuptueshme se Shqipëria, si blerësi, do të mbulojë shpenzimet e shërbimeve të kërkuara dhe të siguruara nga NAMSO mbasi palët të kenë firmosur një marrëveshje, duke përfshirë shpenzimet e dala në rast përfundimi, siç trajtohen në nenin 11.

#### Neni 4

### **Përgjegjësia, garancia dhe sigurimet**

4.1 Secila Palë, që merr materiale ose shërbime brenda këtij Memorandumi të mirëkuptimit, do të heqë dorë nga pretendimet për dëmet (duke përfshirë edhe dëmet që çojnë në vdekje), humbjet ose dëmtimet, në rast se këto dëme, humbje ose dëmtime vijnë nga përdorimi normal dhe/ose veprime gjatë punës me to.

4.2 Palët do t'i ofrojnë njëra-tjetrës mbrojtjen reciproke ndaj çdo ankese a veprimi të çdo lloji natyre që vijnë nga një palë e tretë ndaj njëres prej Palëve dhe së fundi do të mbrojnë organizmin furnizues ndaj ankesave të së njëjtës natyrë të bërë nga palët e treta.

4.3 Dorëheqja dhe mbrojtja e paraqitur në paragrafin 4.1 dhe 4.2 nuk do të zbatohen në rast se ka keqdrejtim të kryer me qëllim, kur ka neglizhencë të plotë ose në rastet kur trajtohet në mënyrë specifike në një marrëveshje të përfunduar prej të dyja Palëve.

4.4 Çdo marrëveshje e tipit që referohet në paragrafin 2.1 do të detajojë garancinë për materialet ose shërbimet në të cilën përfshihet, për çdo sektor të veprimtarisë dhe të detyrave të përfshira.

4.5 Dërgesat e mbuluara nga NAMSO në marrëveshje të tilla normalisht nuk sigurohen, vetëm në rast se kërkohet nga Shqipëria. Shpenzimet për sigurime të tilla, që mund të kërkohen nga Shqipëria, do t'i rimbursohen NAMSO-s pa vonesë.

#### Neni 5

### **Administrimi**

5.1 Departamentet përgjegjëse për administrimin e këtij Memorandumi të mirëkuptimit paraqiten në aneksin 1 bashkëngjitur.

5.2 Për marrëveshjet shtesë të referuara në paragrafin 2.1, Palët mund të përcaktojnë pika specifike kontakti.

#### Neni 6

### **Kërkesa të sigurisë**

6.1 Palët do të zhvillojnë dhe zbatojnë një program të bashkërenduar për sigurimin industrial bazuar në sigurimin C-M(55) 15 (Final) brenda NATO-s.

6.2 Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën mbi klasifikimin e sigurisë të përcaktuar nga Pala që e nxjerr, lidhur me çdo informacion ose të dhënë që do t'i jepet Palës tjetër brenda termave të një marrëveshjeje siç referohet në paragrafin 2.1.

6.3 Çdo shkëmbim informacioni i klasifikuar, duke përfshirë kontrata që përfshijnë informacione të tilla, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen e sigurimit të përfunduar më datë 26 korrik 1994 ndërmjet NATO-s dhe Shqipërisë dhe me kërkesat e sigurisë të përcaktuara në C-M(55) 15 (Final).

#### Neni 7

### **Shkëmbimi i informacionit teknik i nënshtrohet të drejtave të pronësisë**

7.1 Informacioni dhe të dhënat që do të transferohen, lëshohen për njoftim ose shkëmbehen në bazë marrëveshjeje, siç paraqiten në paragrafin 2.1 dhe që identifikohen qartë nga njëra ose nga tjetra Palë përmes një vule, treguesi a një shenje tjetër me shkrim, që tregojnë të drejtën e pronës, do t'u nënshtrohen dispozitave të parashtruara më poshtë.

7.2 Është e kuptueshme se secila nga të dyja Palët ndërmerr:

a) të përdorë informacionin e Palës tjetër vetëm për qëllimet e marrëveshjes, të paraqitura në paragrafin 2.1;

b) të mbrojnë plotësisht sekretin e informacionit që i takon Palës tjetër dhe ta ruajë nga përhapja, transferimi ose vënia e tij në dispozicion të një pale të tretë;

c) të trajtojë informacionin e Palës tjetër si informacion të klasifikuar duke ushtruar të njëjtin kujdes dhe duke përdorur të njëjtin kontroll siç përdor dhe ruan normalisht informacionin e tij. Kjo

bëhet me qëllim që të evitohet përhapja e pakujdesshme, publikimi ose transferimi i tyre dhe për të bërë të ditur se vetëm ata anëtarë të Palës që "kanë nevojë të dinë" kanë të drejtën e hyrjes në informacionin që i takon Palës tjetër.

7.3 Informacioni nuk do t'i nënshtrohet të drejtave të pronës dhe nuk do t'i japë detyrime Palës marrëse kur ky informacion:

a) është brenda ose hyn në fushën publike për qëllime të këqija ose të paligjshme nga ana e Palës marrëse;

b) është dhënë në mënyrë të ligjshme nga një palë e tretë, pa kufizime të ngjashme dhe pa shkelje a kundërvajtje të këtij Memorandumi mirëkuptimi;

c) është miratuar për shpërndarje ose përdorim me autorizim me shkrim nga Pala dorëzuese.

7.4 Në rast se nuk miratohet nga të dyja Palët, asgjë e përfshirë në marrëveshjet përkatëse të tipit të paraqitur në paragrafin 2.1 nuk do të konsiderohet se jep të drejtën ose licencë për patenta, shpikje ose të dhëna, kur zotërohen nga secila Palë.

#### Neni 8

##### Procedurat e vizitave

8.1 Përfaqësuesve të Palëve, me kërkesën e tyre, u jepet e drejta për të hyrë në stabilimentet shtetërore ose private, kur kryhet puna (përfshirë dhe testimet e prona) sipas një marrëveshjeje të përfunduar brenda kuadrit të këtij Memorandumi mirëkuptimi me "nevojën për të ditur" nga ana e përfaqësuesve.

8.2 Organizimi i vizitave u nënshtrohet rregullave të sigurisë, të parashtruara në pikën D të CM (55) 15 (Final) nën titullin "Procedura të vizitave ndërkombëtare". Të gjithë vizitorët do të pajtohen gjithashtu me çdo rregullore shtesë sigurie dhe mbrojtjeje të paraqitur nga vendi pritës. Sekretet tregtare dhe informacioni tjetër teknik i dhënë për vizitorët do të trajtohet sikur t'i ishte dhënë Palës që sponsorizon vizitorët.

#### Neni 9

##### Gjuha

Këtu do të zbatohet politika normale e NATO-s për nxjerrjen e dokumenteve zyrtare në anglisht dhe frëngjisht.

#### Neni 10

##### Amendamente

Dispozitat e këtij Memorandumi të mirëkuptimit mund të ndryshohen me marrëveshje me shkrim të Palëve.

#### Neni 11

##### Përfundimi

11.1 Në rast se njëra nga Palët dëshiron të tërhiqet nga ky Memorandum mirëkuptimi ose prej njëres nga pikat e marrëveshjes të shprehura në paragrafin 2.1, atëherë ajo Palë do t'i japë Palës tjetër njoftim me shkrim 6 muaj më parë mbi synimin e saj.

11.2 Kur njëra nga Palët tërhiqet nga ky Memorandum mirëkuptimi ose nga njëra pikë e marrëveshjes së paraqitur në paragrafin 2.1, atëherë Palët do të konsultohen me njëra-tjetrën në kohë për një tërheqje sa më të kënaqshme.

11.3 Në rast se kërkohet në njoftimin për tërheqje, Palët do të negociojnë, për secilën marrëveshje të referuar në paragrafin 2.1, datën më të afërt të mundshme për tërheqje dhe përcaktimin e çështjeve financiare për detyrat në vazhdim dhe shërbimet që preken nga tërheqja. Pala që tërhiqet do të plotësojë tërësisht premtimet e saj deri në datën konkrete të tërheqjes.

11.4 Në rast se Palët vendosin së bashku të përfundojnë Memorandumin e mirëkuptimit, ata do të përballojnë së bashku shpenzimet e përfundimit.

11.5 Të drejtat dhe përgjegjësitë e Palëve për përhapje dhe përdorim të informacionit teknik, sigurisë, shitjeve dhe transferimit të tyre Palëve të treta, zgjidhja e mosmarrëveshjeve, pretendimeve dhe detyrimeve, si dhe tërheqja e përfundimi do të vazhdojnë, pavarësisht nga tërheqja ose mbyllja nga njëra Palë, prej këtij Memorandumi mirëkuptimi ose pikave të referuara në paragrafin 2.1.

Neni 12

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet Palëve lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi mirëkuptimi do të zgjidhen mes negociatash midis tyre pa kërkuar ndihmë nga ndonjë juridiksion i jashtëm ose ndonjë palë e tretë.

Neni 13

### **Data konkrete**

Ky Memorandum hyn në fuqi në datën, kur ka firmosur pala e fundit.

Neni 14

### **Firmosja**

Nenet e mësipërme përfaqësojnë mirëkuptimin e arritur ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe NAMSO-s. Dy kopjet origjinale të këtij Memorandumi të mirëkuptimit, secila në anglisht dhe frëngjisht janë këtu të nënshkruara dhe versionet e të dyja gjuhëve konsiderohen njësoj autentike.

Në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë

I.Boçka

Ambasador i jashtëzakonshëm dhe i plotfuqishëm  
në NATO

Në emër të Organizatës për Furnizim dhe

Mbështetje

P.D.Markey

Drejtore i Përgjithshëm

Datë 24 janar 2001

Shtesë: Marrëveshja Implementuese në lidhje me shkatërrimin e stoqeve të minave anti-personel, e bashkëngjitur si aneksi 2, përbën një marrëveshje pasuese referuar në paragrafin 2.1 për të cilën Palët janë dakord.

## **ANEKSI 1**

Pikat e kontaktit për të gjitha çështjet që lidhen me dispozitat e këtij Memorandumi të mirëkuptimit janë si më poshtë:

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Delegacioni shqiptar në NATO

B-1110 Bruksel

Tel: 00355 42 40084

Fax: 00355 42 28325

Për NAMSO  
Këshilltari ligjor L-8302 Capellen, Luxembourg  
Tel: 00352 306 36554  
Fax: 00352 308721

## ANEKSI 2

### MARRËVESHJE ZBATUESE SHKATËRRIMI I STOQEVE TË MINAVE ANTI-PERSONEL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Ky aneks do të konsiderohet si marrëveshja zbatuese sipas nenit 2.1 të Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe NAMSO-s.

1. Në 29 shkurt 2000, Republika e Shqipërisë e ratifikoi Konventën e Otavës për ndalimin e përdorimit, magazinimit, prodhimit dhe transferimit të minave anti-personel dhe shkatërrimin e tyre. Në këtë mënyrë ajo ka pranuar obligimin sipas nenit 4 të kësaj Konvente të shkatërrojë minat anti-personel (MAP) brenda katër vjetësh.

2. Komiteti Drejtues Politik Ushtarak i Komitetit të Partneritetit Euroatlantik u mblodh më 17 korrik 2000 dhe aprovoi vijat e përgjithshme në lidhje me Fondin e Besimit të Partneritetit për Paqe për shkatërrimin e stoqeve të minave anti-personel (Ref.PfP/SC-N(2000) 63, 6 korrik 2000).

3. Projekti i parë që do të menaxhohet nëpërmjet fondit të besimit, do të jetë shkatërrimi i stoqeve të minave anti-personel në Republikën e Shqipërisë. Sponsor i projektit do të jetë Kanadaja me Agjencinë e NATO-s për Furnizim dhe Mbështetje (NAMSA) përgjegjëse për zbatimin e projektit.

4. Projekti do të përfshijë vendosjen e linjave të procesit në uzinën e eksplozivëve në Mjekës për shkatërrimin e gjithë stoqeve të MAP-së nëpërmjet çmontimit. Eksplozivët e nxjerrë nga minat do të riciklohen në eksplozivë për shpërthim (amonit) për përdorim në projekte civile për të ndihmuar në rindërtimin e ekonomisë shqiptare. Linjat e procesit në Mjekës do të sigurojnë një themel për zhvillimin e një industrie çmilitarizimi të municioneve për shkatërrimin e kërkuar në mënyrë urgjente të stoqeve të tjera të municioneve në Republikën e Shqipërisë.

5. NAMSA do të realizojë me anë të negociimit një kontratë me uzinën e lëndëve plasëse në Mjekës për asgjësimin e minave anti-personel (MAP). NAMSA do të hartojë një kontratë nëpërmjet një tenderi ndërmjet kompanive me eksperiencë çmilitarizuese të vendeve të NATO-s për hartimin prodhimit dhe instalimin e makinerive speciale të nevojshme për çmilitarizimin e minave anti-personel. Gjithashtu NAMSA do të realizojë një memorandum marrëveshjeje me Forcat e Armatosura Shqiptare për ngarkimin dhe transportimin e minave në Mjekës.

6. Kontributi i Shqipërisë në projekt do të jetë sigurimi i vazhdimësisë së operacionit të uzinës të çmilitarizimit në Mjekës dhe transportimi i minave në Mjekës nga 110 rajone/deposh të identifikuar anembanë territorit të Republikës së Shqipërisë.

7. Republika e Shqipërisë është dakord të zgjerojë, aty ku është e përshtatshme, dispozitat e marrëveshjes së gjendjes së Forcave (SOFA) të nënshkruara në qershor 1999 ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s dhe ambasadorit KUKO, për të gjithë personelin ushtarak, civil dhe kontraktues që mund të jetë i pranishëm në Republikën e Shqipërisë si një rezultat direkt i këtij projekti.

Në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë

I.Boçka  
Ambasador i jashtëzakonshëm dhe i plotfuqishëm  
në NATO

Në emër të Organizatës për Furnizim dhe  
Mbështetje  
P.D.Markey  
Drejtore i Përgjithshëm

Datë 24 janar 2001

**L I G J**  
**Nr.9103, datë 10.7.2003**

**PËR MBROJTJEN E LIQENEVE NDËRKUFITARE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Qëllimi**

Ky ligj synon mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare në gjendjen e tyre natyrore, garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e jetës dhe të ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme, në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke ndaluar veprimtaritë që i rrezikojnë.

Neni 2

**Përkufizime**

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrata e liqenit” është administrata shtetërore që krijohet për mbrojtjen dhe administrimin e liqenit si zonë e mbrojtur.
2. “Habitat” është termi sipas përcaktimit të bërë në pikën 6 të nenit 3 të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”.
3. “Kufiri i vëllimit të përgjithshëm” është vëllimi i ujërave të marra nga liqeni, pa shkaktuar probleme në balancën e tij ujore.
4. “Liqene ndërkufitare” janë rezerva natyrore që ndodhen në kufirin ndërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë dhe shteteve fqinje.
5. “Pellgu ujëmbledhës” është pjesa shqiptare e pellgut, ku ujërat rrjedhin natyrshëm drejt liqenit.
6. “Tarifë e përdorimit të liqenit” është pagesa e personave fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, veprimtaritë e të cilëve ushtrohen në liqen ose në bregun e tij, përjashtojë tarifën e përdorimit të ujit.

Neni 3

**Fusha e veprimit**

Ky ligj zbatohet për liqenet ndërkufitare dhe pellgun e tyre ujëmbledhës si më poshtë:

- a) për pjesën shqiptare të Liqenit të Shkodrës;
- b) për pjesën shqiptare të Liqenit të Ohrit;
- c) për pjesën shqiptare të liqeneve të Prespës.

**KREU II**

**MBROJTJA E LIQENEVE NDËRKUFITARE**

#### Neni 4

### Mbrojtja

1. Për mbrojtjen e gjendjes natyrore të liqeneve ndërkufitare veprojnë të gjitha aktet ligjore e nënligjore, që mbrojnë mjedisin në Republikën e Shqipërisë, si dhe konventat, protokollet, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

2. Janë të detyruar të mbrojnë liqenet ndërkufitare dhe të zbatojnë dispozitat e këtij ligji:

a) personat fizikë e juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, që shfrytëzojnë pasuritë ujore, natyrore dhe biologjike të liqenit e të pellgut ujëmbledhës ose ushtrojnë veprimtari të ndryshme në to;

b) personat fizikë e juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, veprimtaritë e të cilëve janë të vendosura në pellgun ujëmbledhës dhe që me veprimtarinë e tyre mund t'u shkaktojnë dëmtime liqeneve.

#### Neni 5

### Detyrat e organeve shtetërore

Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me organet shtetërore përkatëse, qendrore e vendore dhe me autoritetet e ujit, secili në linjën e vet, organizojnë punën për mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare, kontrollojnë zbatimin e kërkesave të këtij ligji dhe marrin pjesë:

a) në hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të liqeneve ndërkufitare;

b) në hartimin dhe zbatimin e programeve të veçanta të monitorimit;

c) në hartimin dhe zbatimin e planeve vendore për rehabilitimin e pjesëve të ndotura e të dëmtuara të liqeneve ndërkufitare;

ç) në krijimin e kuadrit ligjor, bashkëkohor, për administrimin dhe mbrojtjen mjedisore të tyre;

d) në sigurimin dhe përdorimin e frytshëm të mjeteve të nevojshme financiare;

dh) në kontrollin e vazhdueshëm për të siguruar ruajtjen e gjendjes natyrore të liqeneve ndërkufitare dhe të faunës e florës së tyre.

#### Neni 6

### Mbrojtja ligjore

1. Si ekosisteme unike, me vlera ndërkombëtare, liqenet ndërkufitare me pellgjet e tyre ujëmbledhëse, merren në mbrojtje të veçantë nga shteti, duke u shpallur zona të mbrojtura, mbështetur në ligjet nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura" dhe nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", si dhe në konventat mjedisore, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

2. Për të siguruar një mbrojtje unike për të gjithë ekosistemin, propozimi për shpalljen zonë e mbrojtur, të secilit liqen, bëhet duke mbajtur parasysh edhe statusin që gëzon pjesa tjetër e liqenit në shtetin fqinj.

#### Neni 7

### Elementet e mbrojtjes

Mbrojtja mjedisore e liqeneve ndërkufitare realizohet nëpërmjet:

a) zbatimit me rreptësi të kuadrit ligjor përkatës;

b) zbatimit të metodave shkencore, teknike e teknologjike, kimike, biologjike, statistikore, që sigurojnë cilësinë dhe sasinë e treguesve natyrorë të ujërave për mbrojtjen dhe nxitjen e mbijetesës së larmisë biologjike;

c) hartimit dhe zbatimit të planeve të menaxhimit, duke përfshirë gjithë përbërësit mjedisorë të zonës dhe veprimtaritë që do të ushtrohen, si në ujëra, peshkim, pyje, bujqësi, turizëm, komunikacion e industri;

ç) hartimit dhe zbatimit të programeve konkrete të monitorimit;

d) zbatimit me rreptësi të kërkesave të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

dh) sigurimit dhe përdorimit të frytshëm të mjeteve financiare.

Neni 8  
**Administrata e liqeneve**

1. Për administrimin dhe mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare si zona të mbrojtura, krijohen administratat e liqeneve, në varësi të qarqeve përkatëse.

2. Përbërja, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e administratës së liqenit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të përbashkët të Ministrit të Mjedisit, Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

3. Përfaqësuesit e komunitetit të biznesit të pellgut ujëmbledhës dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore marrin pjesë në mbledhjet e organeve të qeverisjes vendore, ku merren vendime për liqenet dhe pellgjet e tyre ujëmbledhëse.

Neni 9  
**Kuadri nënligjor**

Administrata e liqenit harton rregulloret e veçanta, të nevojshme për administrimin dhe mbrojtjen e pellgut ujëmbledhës dhe ia i paraqet ato për miratim këshillit të qarkut përkatës.

Neni 10  
**Prona**

1. Pjesa shqiptare ujore e liqeneve ndërkufitare është pronë publike e paluajtshme dhe e patjetërsueshme.

2. Pronat e paluajtshme private, si toka bujqësore, toka të pafrytshme, troje, livadhe, kullota, pyje e toka pyjore, që përfshihen në pellgun ujëmbledhës të liqenit, mbeten të tilla edhe pas shpalljes së tij zonë e mbrojtur. Pronarët e tyre gëzojnë të gjitha të drejtat që u jep Kushtetuta dhe legjislacioni përkatës.

KREU III  
**PËRDORIMI DHE SHFRYTËZIMI**

Neni 11  
**Zbatimi i kërkesave të zhvillimit të qëndrueshëm**

1. Në zbatim të kërkesave të zhvillimit të qëndrueshëm në liqenet ndërkufitare, në brigjet dhe pellgjet e tyre ujëmbledhëse, personat fizikë dhe juridikë, publikë e privatë, vendas ose të huaj, ushtrojnë veprimtari ekonomike, tregtare, turistike, shoqërore, sportive, kërkimore-shkencore, me kusht që të jenë në pajtim me statusin e mbrojtjes së pellgut dhe të mos rrezikojnë biodiversitetin e tij.

2. Veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni ushtrohen vetëm kur:

- a) janë pajisur me leje mjedisore;
- b) janë të miratuara nga organet përkatëse, qendrore ose vendore;
- c) ushtrohen në përputhje me kërkesat e planit të menaxhimit të pellgut.

3. Veprimtaritë bujqësore të fermerëve, që jetojnë në territorin e pellgjeve ujëmbledhëse, marrin parasysh kërkesat e planit të menaxhimit të pellgut, sidomos për mbrojtjen e tokës dhe për përdorimin e kimikateve.

4. Zhvillimi urban dhe ndërtimet turistike mbështeten në traditën ndërtimore vendase dhe realizohen në përputhje me kërkesat e planit të menaxhimit të pellgut.

## Neni 12

### **Përdorimi i ujërave të liqeneve**

1. Uji i liqeneve ndërkufitare mund të përdoret vetëm në mënyrë të kontrolluar dhe në kufij të përcaktuar shkencorë, pa dëmtuar kushtet natyrore dhe balancat biologjike dhe ekologjike të tyre.

2. Qëllimet e përdorimit, sasitë dhe regjimi i përdorimit të ujërave të liqeneve, për çdo rast konkret, respektojnë marrëveshjet me shtetet kufitare për problemet e liqeneve.

## Neni 13

### **Veprimtaritë kërkimore-shkencore**

1. Veprimtaritë kërkimore-shkencore në liqenet ndërkufitare kryhen me miratimin e agjencisë rajonale të mjedisit të qarkut përkatës ose të Ministrisë së Mjedisit. Me udhëzim të veçantë Ministri i Mjedisit klasifikon veprimtaritë kërkimore-shkencore, që miratohen nga agjencia rajonale e mjedisit dhe ato që miratohen nga Ministria e Mjedisit.

2. Institutet kërkimore-shkencore, institucionet e tjera të interesuara dhe grupet e studiuesve paraqesin programet e veprimtarisë që do të zhvillojnë dhe mbi bazë të këtij dokumentacioni jepet miratimi i veprimtarisë.

3. Në përfundim të veprimtarisë kërkimore-shkencore hartohet raporti përfundimtar, një kopje e të cilit dorëzohet në Ministrinë e Mjedisit, e cila respekton të drejtat e autorit dhe ruan karakterin konfidencial të raportit.

## Neni 14

### **Veprime të ndaluara**

1. Në liqenet ndërkufitare dhe pellgjet e tyre ujëmbledhëse janë të ndaluara:

- a) hedhjet ose depozitimet e lëndëve dhe të mbetjeve të rrezikshme;
  - b) shkarkimet e ujërave të ndotura e të patrajtuara urbane, industriale, bujqësore dhe të çdo veprimtarie njerëzore;
  - c) depozitimet dhe hedhjet e mbetjeve të çdo lloji;
  - ç) ndërtimi e funksionimi pranë tyre i venddepozitimeve të mbetjeve dhe i dambave të minierave e degëve të industrisë përpunuese;
  - d) betonimet në breg, që ndërpresin komunikimet e shumëfishta ndërmjet ujit dhe tokës;
  - dh) ndërtimi i godinave, i instalimeve dhe i çdo formacioni inxhinierik në breg dhe brenda zonës së ndaluar për ndërtime;
  - e) marrja e rërës, e zhavorreve dhe e çdo materiali tjetër të brigjeve dhe të cektinave të liqeneve, siç përcaktohet në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", i ndryshuar;
  - ë) çelja e gurorëve, ndërtimi i furrave të gëlqeres, instalimi i impianteve të asfalto-betonit pranë zonave urbane dhe në vende që dëmtojnë peizazhin e zonës;
  - f) shfrytëzimi i ujit të liqeneve pa leje dhe jashtë kushteve të vëna në licencë;
  - g) prerja e pakontrolluar e pemëve dhe e pyjeve;
  - gj) shfrytëzimi pa kriter i kullotave dhe djegia e tyre;
  - h) ushtrimi i peshkimit dhe i gjuetisë jashtë sezoneve e kalendarëve përkatës dhe me metoda, mënyra dhe mjete të ndaluara me ligj;
  - i) mbledhja e bimëve mjekësore, tarnifere dhe eterovajore me mënyra, metoda e në periudha të ndaluara;
  - j) mbledhja e kërmijve, bretkosave, breshkave e reptilëve me mënyra, metoda dhe në periudha të ndaluara;
  - k) kapja, për qëllime tregtimi, e peshqëve, e kafshëve dhe e shpendëve të rrallë dhe të rrezikuar;
  - l) futja në liqen dhe në zonën ujëmbledhëse e gjallesave (peshq, kafshë, shpendë, bimë) të popullatave jovendase.
2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, miraton ndalimin e ushtrimit të veprimeve të tjera në liqenet ndërkufitare, të cilat diktohen në të ardhmen nga praktika.

## KREU IV LEJA MJEDISORE

### Neni 15 **Leja mjedisore**

1. Veprimtaritë në liqenet ndërkufitare, përfshi edhe punimet ndërtimore, turistike, sportive, hortikulturën, akuakulturën dhe hidrometeorologjike, mund të ushtrohen vetëm pasi të jenë pajisur me leje mjedisore dhe të përmbushin kushtet e përcaktuara nga Ministria e Mjedisit, Autoriteti i Ujit, KRRTRSH-ja dhe KRRT-të vendore.

2. Projektet dhe veprimtaritë, që kërkojnë të ushtrohen në liqenet ndërkufitare, përgatisin raportin e thelluar të ndikimit në mjedis.

3. Strategjitë dhe planet për zhvillimin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë e shoqërorë, zbatimi i të cilëve do të shtrihet edhe mbi liqenet ndërkufitare, i nënshtrohen, para se të miratohen dhe të zbatohen, vlerësimit strategjik mjedisor.

### Neni 16 **Tarifa**

1. Krahas shpenzimeve administrative për marrjen e lejes mjedisore dhe të licencave përkatëse, personi fizik ose juridik, që zhvillon veprimtari në liqenet ndërkufitare dhe në brigjet e tyre, paguan edhe tarifën e përdorimit të liqenit. Tarifa derdhet për llogari të organeve të qeverisjes vendore dhe përdoret për mbrojtjen dhe rehabilitimin e liqenit. Tarifa e përdorimit të ujit të liqeneve mbledhet nga autoriteti i ujit.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e përbashkët të Ministrit të Mjedisit, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, miraton masën e tarifës, të specifikuar sipas llojit të veprimtarive.

## KREU V MONITORIMI DHE MENAXHIMI

### Neni 17 **Monitorimi**

1. Liqenet ndërkufitare dhe zonat e tyre ujëmbledhëse i nënshtrohen monitorimit të vazhdueshëm, për të mbajtur nën kontroll cilësinë e tyre dhe llojshmërinë biologjike.

2. Programi i monitorimit të liqeneve ndërkufitare është pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit. Ai hartohet dhe zbatohet nën drejtimin e Ministrisë së Mjedisit, në bashkëpunim me DPPK-në, Drejtorinë e Peshkimit e me institutet e specializuara. Programi është i veçantë për secilin liqen ndërkufitar.

3. Programet e monitorimit përfshijnë:

- a) përcaktimin e treguesve që do të maten;
- b) përcaktimin e metodave e të metodikave të matjeve;
- c) frekuencën e matjeve;
- ç) metodat e metodikat e analizave dhe të shqyrtimit të të dhënave për nxjerrjen e përfundimeve shkencore;
- d) përcaktimin e rregullave e të procedurave për ekspertizën e procesit monitorues;
- dh) miratimin e regjistrave, ku pasqyrohen të dhënat e monitorimit.

4. Personat fizikë e juridikë, të pajisur me leje mjedisore për të ushtruar veprimtari në liqene, në bregun e tyre ose në zonën ujëmbledhëse, janë të detyruar të monitorojnë veprimtarinë që ushtrojnë, sipas programit të monitorimit, të regjistrojnë të dhënat në regjistrin vetjak dhe të bëjnë publikimin e tyre jo më rrallë se një herë në tre muaj. Shpenzimet për monitorimin e veprimtarisë i përballon vetë subjekti.

5. Inspektorati i Mjedisit dhe administrata e mbrojtjes së zonës kontrollojnë regjistrin e të

dhënave të monitorimit dhe, kur dyshojnë në vërtetësinë e tyre, urdhërojnë ekspertizën e monitorimit. Shpenzimet për ekspertizën janë në ngarkim të subjektit.

#### Neni 18 **Inventarizimi**

1. Me qëllim që gjallesat dhe habitatet e tyre në liqenet ndërkufitare dhe në zonat e tyre ujëmbledhëse të mbrohen nga zhdukja apo rrezikimi dhe të zhvillojnë normalisht jetën e tyre, bëhet inventarizimi i tyre. Në bazë të inventarizimit hartohet e zbatohet programi i masave për mbrojtjen e llojshmërisë biologjike e të habitateve.

2. Inventarizimi kryhet nën kujdesin e administratës së liqenit dhe me pjesëmarrjen e organeve e të institucioneve të specializuara kërkimore-shkencore dhe të organizatave jofitimprurëse mjedisore.

3. Ministri i Mjedisit miraton me udhëzim rregullat, kriteret, metodikat dhe dokumentet standarde për kryerjen e inventarizimit, të cilat hartohen nga institucionet e specializuara shkencore.

#### Neni 19 **Skedimi**

1. Për gjallesat bimore e shtazore të çdo liqeni ndërkufitar ngrihet skedari rajonal, si pjesë e Skedarit Kombëtar. Skedari është dokumentacioni shkencor, ku pasqyrohet e tërë larmia biologjike e liqenit dhe e zonës ujëmbledhëse. Skedari është i hapur për publikun.

2. Kriteret e hartimit të skedarit, rregullat e administrimit dhe të shfrytëzimit të tij përpunohen nga institucionet e specializuara qendrore e vendore dhe miratohen me udhëzim nga Ministri i Mjedisit.

3. Administrata e mbrojtjes së liqeneve i propozon, sipas rastit, Ministrisë së Mjedisit, Këshillit Kombëtar të Ujit, DPPK-së, Drejtorisë së Peshkimit dhe organeve të qeverisjes vendore masa të përkohshme apo të përhershme, për të përsosur mbrojtjen e biodiversitetit.

#### Neni 20 **Menaxhimi**

1. Administrimi i liqeneve ndërkufitare kryhet në bazë të planeve të menaxhimit që hartohen nga Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, me organet e qeverisjes vendore, institutet kërkimore-shkencore dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore.

2. Planet e menaxhimit të liqeneve ndërkufitare përfshijnë:

- a) objektivat e menaxhimit të liqenit;
- b) identifikimin e detyrave të organeve të ndryshme shtetërore, të institucioneve studimore, të organizatave mjedisore dhe të komunitetit vendor, për administrimin dhe mbrojtjen e liqeneve;
- c) proceset dhe veprimtaritë kërcënuese për liqenin;
- ç) masat për të mënjnuar apo reduktuar kërcënimet e identifikuar;
- d) veprimtaritë e lejuara në liqen, në brigje dhe zonën ujëmbledhëse;
- dh) kushtet për kontrollin e turizmit dhe të shërbimeve të tjera;
- e) kushtet për vazhdimësinë e veprimtarive tradicionale të banorëve të zonës;
- ë) kushtet për të ndarë me komunitetet vendore përfitimet nga krijimi dhe administrimi i liqeneve si zonë e mbrojtur;
- f) kushtet për kërkimin shkencor, inventarizimin dhe monitorimin;
- g) burimet financiare, duke përfshirë ato që sjellin fitim;
- gj) kushtet e tjera të veçanta për liqenin konkret.

Planet e menaxhimit duhet të jenë konform konventave ndërkombëtare për mbrojtjen dhe administrimin e liqeneve, si dhe të respektojnë marrëveshjet me shtetet kufitare.

3. Kushtet dhe kriteret e planeve të menaxhimit janë të detyrueshme për personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas ose të huaj, veprimtaritë e të cilëve ushtrohen në liqen e në zonën ujëmbledhëse apo ndikojnë në to. Administrata e liqenit, agjencia rajonale e mjedisit, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Drejtoria e Peshkimit, Autoriteti i Ujit, DPPK-ja, secila në linjën e vet, ndjekin me përparësi zbatimin e kërkesave të planit të menaxhimit.

4. Aktorët pjesëmarrës në hartimin e planeve të menaxhimit detyrohen të rishikojnë dhe të rinovojnë planin e menaxhimit jo më vonë se 1 herë në 2 vjet dhe për çdo ndryshim njoftojnë shtetet kufitare.

## KREU VI KONTROLLI

### Neni 21 Kontrolli

1. Për të siguruar zbatimin e kërkesave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, liqenet ndërkufitare, brigjet e tyre, zonat ujëmbledhëse, si dhe veprimtaritë që ushtrohen në to, i nënshtrohen kontrollit të vazhdueshëm e të përhershëm mjedisor.

2. Veprimtaritë ekonomike, tregtare, turistike, shoqërore, sportive, që ushtrohen në liqene, në brigjet e tyre e në zonat ujëmbledhëse, kontrollohen në mënyrë të përgjithshme, për të hetuar ndikimet negative në mjedis dhe në mënyrë të posaçme për të vlerësuar respektimin e kërkesave që u janë fiksuar në lejet mjedisore e në licencat përkatëse, të marra sipas legjislacionit në fuqi.

3. Kontrolli ushtrohet nga Autoriteti i Ujit, nga administrata e liqenit, nga Inspektorati i Mjedisit në bashkëpunim me Inspektoratin e Peshkimit, me Policinë e Ndërtimit, me Policinë e Shërbimit Pyjor dhe me Policinë Bashkiake, si dhe nga organet që kanë licencuar veprimtaritë, të cilët ushtrojnë kompetenca sipas ligjeve, që i kanë krijuar këto organe.

4. Brenda 5 ditëve nga përfundimi i kontrollit, Inspektorati i Mjedisit publikon rezultatet e kontrollit dhe masat që ka marrë për përmirësimin e gjendjes.

## KREU VII SANKSIONET

### Neni 22

1. Kur shkeljet e kërkesave të këtij ligji përbëjnë vepër penale, Inspektorati i Mjedisit dhe administrata e liqenit bëjnë kallëzim për ndjekje penale.

2. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative:

a) kryerja e veprimeve të ndaluara, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 14 të këtij ligji;

b) ushtrimi i veprimtarive pa leje mjedisore;

c) mosrespektimi i kushteve dhe i kërkesave të vendosura në lejet mjedisore;

ç) ndotja dhe dëmtimi i ujërave të liqeneve, duke shkarkuar në to lëndë dhe mbetje të lëngëta, të ngurta ose të gazta, të cilat dëmtojnë cilësinë e ujit, biodiversitetin dhe plazhet e liqeneve, dënohet me gjobë dhe me heqje licence;

d) shkelja e kërkesave dhe e rregullave të funksionimit të impianteve dhe e instalimeve, që bëjnë trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura të zonës, si dhe të atyre që bëjnë përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve të ngurta;

dh) moskryerja e procesit të monitorimit nga veprimtaritë që ushtrohen;

e) mosmbajtja e regjistrit të monitorimit;

ë) mosdhënia dhe mospublikimi i të dhënave, që rezultojnë nga monitorimi;

f) mosnjoftimi i popullatës për ndotjen e ujërave, në rastet e shkarkimeve në to tej normave të lejuara, për rreziqet e mundshme në shëndet dhe për masat mbrojtëse që ajo duhet të marrë në këtë rast.

### Neni 23

1. Për kundërvajtjet administrative të përcaktuara në nenin 22, jepen dënime me gjobë si më poshtë:

a) për shkronjat "dh", "e", "ë" dhe "f".... nga 100 000 deri në 300 000 lekë;

b) për shkronjat "b", "c" dhe "d"..... nga 300 000 deri në 500 000 lekë;

c) për shkronjat "a" dhe "ç".....nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

2. Krahas dënimit me gjobë, Inspektorati i Mjedisit mund të vendosë mbylljen e përkohshme ose të përhershme të veprimtarisë, në varësi të ndotjes dhe të dëmtimit të shkaktuar.

Neni 24

#### **Ankimi**

1. Kundër vendimit të Inspektoratit të Mjedisit mund të bëhet ankim pranë Ministrit të Mjedisit brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit ose nga marrja e njoftimit. Ministri i përgjigjet ankimit brenda 15 ditëve nga depozitimi i tij.

2. Kundër vendimit të Ministrit të Mjedisit, ose kur ky i fundit nuk përgjigjet brenda afatit 15-ditor, mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit në gjykatën e rrethit, ku është bërë kundërvajtja.

Neni 25

#### **Dispozita kalimtare dhe të fundit**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6 pika 1, 8 pika 2, 14 pika 2 dhe 16 pika 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë masat tekniko-administrative dhe financiare për të larguar, brenda vitit 2004, dambën e mbeturinave të hekur-nikelit nga pellgu ujëmbledhës i Liqenit të Ohrit.

Neni 26

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3917, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

### **L I G J**

**Nr.9104, datë 17.7.2003**

#### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E PARANDALIMIT TË PËRHAPJES SË ARMËVE TË SHKATËRRIMIT NË MASË DHE FORCIMIT TË MARRËDHËNIEVE USHTARAKE DHE TË MBROJTJES”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lidhur me bashkëpunimin në fushën e parandalimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe forcimit të marrëdhënieve ushtarake dhe të mbrojtjes”.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3918, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

### MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË  
BASHKUARA TË AMERIKËS LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E  
PARANDALIMIT TË PËRHAPJES SË ARMËVE TË SHAKTËRRIMIT NË MASË DHE  
FORCIMIT TË MARRËDHËNIEVE USHTARAKE DHE TË MBROJTJES

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që më poshtë do të referohen si Palët:

me qëllim që të ndalojnë përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, si dhe të teknologjisë, materialeve dhe ekspertizës që lidhen me armë të tilla;

me dëshirën për të parandaluar transferimin dhe transportimin e paautorizuar, përfshi kalimin transit të armëve bërthamore, biologjike e kimike, të materialeve, të teknologjisë dhe ekspertizës që lidhen me armë të tilla;

me dëshirën për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë në fushën e marrëdhënieve ushtarake dhe të mbrojtjes,

ranë dakord si më poshtë:

## Neni 1

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sipas nevojës, mund të ndihmojë Qeverinë e Republikës së Shqipërisë në arritjen e objektivave të mëposhtme:

a) të ndalojë përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, si dhe të teknologjisë, materialeve dhe ekspertizës që lidhen me to, që mund të hyjnë ose të dalin nëpërmjet Republikës së Shqipërisë;

b) të parandalojë transferimin, përfshi kalimin transit dhe transportin e paautorizuar të armëve bërthamore, biologjike ose kimike dhe të materialeve, teknologjisë dhe ekspertizës që lidhen me to;

c) të sigurojë magazinimin dhe transportimin e sigurt dhe të garantuar të armëve të shkatërrimit në masë;

d) forcimin e marrëdhënieve ushtarake dhe të mbrojtjes, që përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me takime të rregullta ndërmjet zyrtarëve ushtarakë të nivelit të lartë dhe të mesëm, vizita, shkëmbime dhe aktivitete të tjera kontakti dypalësh;

e) objektiva të tjera, siç është rënë dakord reciprokisht me shkrim nga Palët.

## Neni 2

1. Palët nëpërmjet agjentëve të tyre ekzekutivë, mund të bien dakord për marrëveshje dhe masa zbatuese sipas nevojës për të arritur objektivat e përcaktuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshjet dhe masat zbatuese mund të përfshijnë, por nuk mund të kufizohen në:

a) dispozitat lidhur me aksesin e materialeve, trajnimit ose shërbimeve që jepen në qendrat ose përdorimin e tyre për monitorim dhe inspektim;

- b) dispozitat lidhur me kontrollet dhe shqyrtimet, mbikëqyrjen dhe menaxhimin.
2. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis kësaj Marrëveshjeje dhe ndonjë marrëveshjeje ose masave të tjera zbatuese, do të zbatohen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 3

Secila Palë do të caktojë një agjent ekzekutiv për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, agjenti ekzekutiv do të jetë Ministria e Mbrojtjes, në rast të kundërt Qeveria e Republikës së Shqipërisë njofton Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, agjenti ekzekutiv do të jetë Departamenti i Mbrojtjes, në rast të kundërt Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës njofton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

### Neni 4

Përveç përjashtimeve që paraqiten në këtë Marrëveshje ose në ndonjë marrëveshje tjetër zbatuese, kushtet e kësaj Marrëveshjeje janë të zbatueshme për të gjitha pajisjet, furnizimet, mallrat dhe materialet e tjera, teknologjinë, trajnimet ose shërbimet e ofruara në përputhje me këtë Marrëveshje ose me marrëveshjet zbatuese, si dhe për të gjitha veprimtaritë dhe personelin përkatës. Të gjitha pajisjet, furnizimet, materialet ose mallrat e tjera, teknologjia, trajnimi ose shërbimet e ofruara në përputhje me këtë Marrëveshje do të përdoren ekskluzivisht për qëllimin për të cilin ofrohen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

### Neni 5

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të lehtësojë hyrjen dhe daljen e punonjësve të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të personelit kontraktues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim që të kryejnë veprimtaritë e tyre në përputhje me këtë Marrëveshje.

2. Ndryshe nga aeroplanët dhe anijet e rregullta të planifikuara komerciale, aeroplanët dhe anijet që përdoren nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në zbatim të veprimtarive që rrjedhin nga kjo Marrëveshje në Republikën e Shqipërisë do të përjashtohen nga kontrollet doganore, tarifatat doganore, detyrimet tokësore e lundruese, tarifatat portuale, tarifatat rrugore dhe nga çfarëdo detyrimi tjetër që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Në rast se një aeroplan, ndryshe nga një aeroplan i rregullt komercial, përdoret nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për transport në Republikën e Shqipërisë, plani i tij i fluturimit duhet të realizohet në përputhje me procedurat e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) të aplikueshme për mjetet e fluturimit civil, duke përfshirë në paragrafin e vërejtjeve për planin e fluturimit një konfirmim se është marrë leja e duhur për kalim. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, siguron, jo me shpenzime të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, karburant, parkim, mbrojtje sigurie dhe shërbim për mjetet e fluturimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

### Neni 6

Në rast se nuk është marrë së pari një miratim me shkrim nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk mund të pretendojë pronësi, të kalojë pronësi ose të përvetësojë ndonjë pajisje, furnizime, materiale ose mallra të tjera, teknologji, trajnime ose shërbime që ofrohen si rrjedhojë e kësaj Marrëveshjeje për një person ose një entitet tjetër, përveç një oficeri, punonjësi ose agjenti të njëres prej Palëve në këtë Marrëveshje dhe nuk do të lejojë përdorimin e këtyre pajisjeve, furnizimeve, materialeve ose produkteve të tjera, teknologjisë, trajnimit ose shërbimeve për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë dhënë. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të marrë të gjitha masat e domosdoshme brenda kompetencave të saj për të garantuar sigurinë e pajisjeve, furnizimeve, materialeve ose mallrave të tjera, teknologjisë, trajnimit dhe shërbimeve të ofruara në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe do t'i mbrojë ato ndaj keqpërdorimit dhe konfiskimit.

## Neni 7

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me procedurat dhe kërkesat ligjore, përveç kërkesave kontraktuese, do të mbrojë nga dëmtimet dhe do të shpërblejë Qeverinë e Shteteve të Bashkuara dhe personelin e saj, kontraktuesit dhe personelin e kontraktuesve për dëmtimet e pronës, vdekjen ose lëndimin e ndonjë personi në Republikën e Shqipërisë, që ndodhin gjatë veprimtarive në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Dispozitat e këtij neni nuk do t'i ndalojnë Palët të japin kompensime në përputhje me legjislacionin e vendeve të tyre.

3. Në këtë nen asgjë nuk duhet interpretuar për të penguar procedurat ose kërkesat ligjore ndaj shtetasve të Republikës së Shqipërisë ose personave që banojnë në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 8

Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, aktiviteti i Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës varet nga disponueshmëria e fondeve të dhëna.

## Neni 9

Punonjësve ushtarakë dhe civilë të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (përfshi edhe pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës) të pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë për veprimtari që lidhen me këtë Marrëveshje, do t'u jepen privilegje dhe imunitete të barabarta me ato që u ofrohen stafit administrativ dhe teknik në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të 18 prillit 1961.

## Neni 10

1. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, personeli i saj, kontraktuesit dhe personeli i kontraktuesve nuk kanë detyrime të paguajnë asnjë taksë ose tarifë të ngjashme të vendosur nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose ndonjë organ tjetër vartës ose zbatues i saj, në lidhje me veprimtaritë që ndërmerren në përputhje me këtë Marrëveshjeje.

2. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, personeli i saj, kontraktuesit dhe personeli i kontraktuesve mund të importojnë dhe të eksportojnë nga Republika e Shqipërisë çdo pajisje, furnizim, material ose mallra të tjera, teknologji, trajnim dhe shërbime që kërkohen për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Importi dhe eksporti i artikujve ose shërbimeve të tilla nuk do t'i nënshtrohen asnjë kontrolli doganor dhe do të përjashtohen nga licencat, kufizime të tjera, detyrime doganore, taksat ose tarifatat e tjera të vendosura nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose nga ndonjë organ vartës ose zbatues i saj.

## Neni 11

Në rast se Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidh kontrata për sigurimin e artikujve dhe të shërbimeve, përfshi ndërtimin, për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, kontrata të tilla do të lidhen në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sigurimi i artikujve dhe shërbimeve në Republikën e Shqipërisë nga ana e ose në emër të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nuk do t'i nënshtrohet asnjë takse, detyrimi doganor ose detyrimeve të ngjashme të vendosura nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose nga ndonjë organ vartës ose zbatues i saj.

## Neni 12

Me një kërkesë me shkrim të paraqitur tridhjetë ditë përpara, përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë të drejtën gjatë periudhës së kësaj Marrëveshjeje dhe për tre vjet pas kësaj periudhe, të kontrollojnë dhe shqyrtojnë përdorimin e çdo pajisjeje, furnizimi, materiali ose

mallrave të tjera, teknologjisë, shërbimeve në përputhje me këtë Marrëveshje, në vendet ku ndodhen ose përdoren ato dhe do të kenë të drejtën të kontrollojnë dhe shqyrtojnë të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin që lidhet me përdorimin e pajisjeve, furnizimeve, materialeve, mallrave, teknologjive, trajnimeve dhe shërbimeve të ofruara nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në përputhje me këtë Marrëveshje.

#### Neni 13

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj dhe do të jetë e vlefshme për shtatë vjet. Marrëveshja mund të ndryshohet ose zgjatet me marrëveshje me shkrim ndërmjet Palëve dhe mund të përfundohet nga secila Palë me një njoftim me shkrim dërguar Palës tjetër 90 ditë përpara qëllimit të saj për të vepruar kështu. Pavarësisht përfundimit të kësaj Marrëveshjeje ose të marrëveshjeve zbatuese, detyrimet e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë në përputhje me nenet 6, 7, 9 dhe 10 të kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të zbatohen pa marrë parasysh kohën, në rast se Palët nuk bien dakord me shkrim për të vepruar ndryshe. Pavarësisht nga përfundimi i kësaj Marrëveshjeje ose të marrëveshjeve zbatuese, të drejtat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara sipas nenit 12 do të vazhdojnë të jenë në fuqi në përputhje me kushtet e këtij neni.

Nënshkruar në Uashington D.C. sot më 12 maj 2003 në dy kopje, secila në gjuhën angleze dhe shqipe, të dy tekstet janë autentikisht të njëjtë.

### L I G J

**Nr.9106, datë 17.7.2003**

## **PËR SHËRBIMIN SPITALOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### V E N D O S I:

#### **K R E U I D I S P O Z I T A T Ë P Ë R G J I T H S H M E**

#### Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë organizimin, financimin, funksionimin dhe kontrollin e veprimtarisë në fushën e shërbimit spitalor në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 2

#### **Shërbimi spitalor**

Shtetasit shqiptarë dhe të huaj përfitojnë shërbim spitalor në spitalet publike dhe jopublike, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave të këtij ligji.

#### Neni 3

1. Spitalet janë institucione të pajisura me shtretër, që ofrojnë shtrim dhe shërbime shëndetësore të deklaruara ndaj të sëmurve.

2. Hapja dhe mbyllja e spitaleve bëhen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 4

Spitalet sigurojnë:

- a) ndihmë mjekësore të përgjithshme dhe të specializuara;
- b) mbrojtjen e shëndetit në bashkëpunim edhe me veprimtaritë e institucioneve të tjera shëndetësore;
- c) kushtet e duhura për përvetësimin e praktikës së punës dhe edukimin profesional dhe teknik të personelit shëndetësor dhe teknik;
- ç) nxitjen e edukimit higjieno-sanitar të të sëmurit dhe të të afërmeve të tij, duke u mbështetur në personelin e vet shëndetësor.

#### Neni 5

1. Shërbimi spitalor në Republikën e Shqipërisë është publik dhe jopublik, i përgjithshëm dhe i specializuar.
2. Ndarja në spitale publike dhe jopublike bëhet në bazë të përkatësisë së pronës dhe të financimit, si dhe në bazë të qëllimit të ushtrimit të veprimtarisë.
3. Spitalet janë të përgjithshme ose të specializuara, në bazë të natyrës së shërbimeve që ofrojnë.

#### Neni 6

1. Spitalet publike dhe jopublike janë të detyruara të shtrojnë e t'i japin ndihmë mjekësore shtetasve shqiptarë dhe të huaj, të siguruar ose jo, që kanë nevojë për shërbim spitalor urgjent për çfarëdo sëmundje ose aksident.
2. Dokumentet e duhura të shpenzimeve për ndihmën e dhënë plotësohen pas shtrimit.
3. Kriteret për përcaktimin e gjendjes së të sëmurit, që ka nevojë për ndihmë mjekësore urgjente, si dhe dokumentacioni i duhur për mbulimin e shpenzimeve të bëra përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 7

1. Spitali publik ofron shërbim mjekësor për të sëmurët e shtruar, si dhe shërbime mjekësore për të sëmurët ambulatorë, sipas kriterëve të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.
2. Spitalet jopublike ofrojnë shërbime mjekësore, sipas kriterëve të pasqyruara në aktin e themelimit të tyre dhe në përputhje me marrëveshjet për shërbimet shëndetësore transkufitare.

#### Neni 8

Spitalet detyrohen të zbatojnë të drejtat e të sëmurve të shtruar, sipas "Kartës së të drejtave të pacientit", të pranuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

#### Neni 9

Spitalet publike dhe jopublike, për shërbimet që ofrojnë, kanë të drejtë të lidhin kontrata dhe marrëveshje me shoqëritë e sigurimeve shëndetësore, publike ose private, vendase ose të huaja.

#### Neni 10

Organizimi i shërbimit spitalor publik bëhet në përputhje me strategjinë e sistemit shëndetësor të Republikës së Shqipërisë.

## KREU II

### STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I AUTORITETIT SPITALOR PUBLIK TË QARKUT

#### Neni 11

##### **Organizimi i autoritetit spitalor publik të qarkut**

1. Çdo autoritet spitalor i qarkut përfshin një ose më shumë spitale, të cilat ofrojnë shërbime mjekësore që, nga pikëpamja funksionale, janë të pavarura dhe veprojnë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të shërbimit spitalor, vendor dhe shtetëror.

2. Ministri i Shëndetësisë mbikëqyr institucionalisht zbatimin e strategjisë së zhvillimit dhe garanton standardet e shërbimit spitalor publik, bazuar në legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 12

##### **Organet drejtuese të autoritetit spitalor të qarkut**

Organet e autoritetit spitalor të qarkut janë:

- a) këshilli administrativ;
- b) drejtoria;
- c) komisioni mjekësor.

#### Neni 13

##### **Këshilli administrativ**

1. Këshilli administrativ i autoritetit spitalor të qarkut përbëhet nga:

- a) dy anëtarë të caktuar nga këshilli i qarkut ku ndodhet autoriteti spitalor i qarkut;
- b) një anëtar i caktuar nga çdo këshill bashkiak ku ndodhen spitalet në nivel bashkie;
- c) një përfaqësues i caktuar nga prefekti i qarkut;
- ç) presidenti i urdhrit të mjekut të qarkut;
- d) drejtori i autoritetit spitalor;
- dh) drejtori i drejtorisë së sigurimeve të kujdesit shëndetësor të qarkut ose një person i autorizuar prej tij;

e) kryeinfermieri i përgjithshëm i spitalit të qarkut.

2. Në mbledhjen e këshillit administrativ marrin pjesë pa të drejtë vote:

- a) kryetari i komisionit mjekësor të autoritetit spitalor të qarkut;
- b) zëvendësdrejtori ekonomik, i cili kryen edhe funksionet e sekretarit të këshillit administrativ.

3. Këshilli administrativ zgjidhet për një periudhë kohe 3-vjeçare. Anëtarët e këshillit administrativ kanë të drejtë rizgjedhjeje.

4. Nuk mund të jenë anëtarë të këshillit administrativ personat që janë aksionerë të spitaleve ose të institucioneve shëndetësore të tjera jopublike.

#### Neni 14

##### **Funksionet e këshillit administrativ**

Këshilli administrativ ushtron këto funksione:

a) miraton politikat, harton programet tekniko-financiare për konkretizimin e planeve afatshkurtra dhe afatgjata në fushën e shërbimit spitalor të qarkut, në përputhje me strategjinë dhe politikat shtetërore shëndetësore, të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë;

b) programon dhe i propozon Ministrit të Shëndetësisë ndryshimet strukturore të autoritetit spitalor të qarkut;

c) propozon projektbuxhetin, ndarjen dhe destinacionin e tij;

ç) vendos për pranimin e dhuratave nga individë ose fondacione dhe shoqata me qëllim bamirësie, si dhe binjakëzimin me spitalet simotra;

d) i propozon Ministrit të Shëndetësisë emërimin dhe shkarkimin e drejtorit ekzekutiv të

autoritetit spitalor të qarkut;

dh) emëron dhe shkarkon drejtorët e spitaleve të qarkut, në bazë të propozimit të bërë nga drejtori ekzekutiv.

#### Neni 15

### **Rregullat e funksionimit të këshillit administrativ**

1. Këshilli administrativ mblidhet:

a) jo më pak se 6 herë në vit;

b) me kërkesë të kryetarit ose të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve.

2. Mbledhjet e jashtëzakonshme zhvillohen me kërkesën e Ministrit të Shëndetësisë në çdo kohë, si dhe me kërkesën e më shumë se gjysmës së anëtarëve.

3. Këshilli administrativ merr vendime me shumicë votash. Vendimet e këshillit administrativ merren kur janë të pranishëm dy të tretat e anëtarëve.

Vendimet e këshillit administrativ mund të anulohen vetëm me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, kur ato bien në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi ose me strategjinë shtetërore të zhvillimit të shërbimit spitalor.

4. Mbledhja e parë e këshillit administrativ thirret nga drejtori ekzekutiv.

#### Neni 16

### **Kryetari i këshillit administrativ**

1. Këshilli administrativ i autoritetit spitalor të qarkut zgjedh kryetar një nga anëtarët e vet.

2. Kryetari i këshillit administrativ zgjidhet një herë në tre vjet me të drejtë rizgjedhjeje dhe:

a) përfaqëson këshillin administrativ në marrëdhënie me të tretët;

b) drejton mbledhjet e këshillit dhe është përgjegjës për mbarëvajtjet e tyre.

3. Përfaqësuesi i sigurimeve shëndetësore të qarkut dhe drejtori i autoritetit spitalor të qarkut nuk mund të zgjidhen kryetar të këshillit administrativ.

#### Neni 17

### **Shkrirja e këshillit administrativ**

1. Këshilli administrativ i autoritetit spitalor të qarkut mund të shkrihet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë kur:

a) shumica e anëtarëve jep dorëheqjen;

b) vihen re shkelje të dispozitave që rregullojnë veprimtarinë e autoritetit spitalor të qarkut dhe cenojnë interesat e tij.

2. Këshilli administrativ duhet të ngrihet sërish brenda 3 muajve nga data e daljes së urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë për shkrimin e tij.

3. Kundër urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e daljes së urdhrit.

#### Neni 18

### **Përbërja e drejtorisë së autoritetit spitalor të qarkut**

1. Drejtoria e autoritetit spitalor të qarkut përbëhet nga:

a) drejtori ekzekutiv;

b) zëvendësdrejtori teknik;

c) zëvendësdrejtori ekonomik;

ç) kryeinfermieri i përgjithshëm.

2. Struktura dhe rregullat e funksionimit të administratës së autoritetit spitalor të qarkut përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Në përbërjen e drejtorisë së autoritetit spitalor të qarkut nuk lejohet emërimi i drejtuesve ose specialistëve që kanë interesa vetjakë në spitalet jopublike.

#### Neni 19

##### **Funksionet e drejtorit ekzekutiv**

Drejtori ekzekutiv është drejtuesi ekzekutiv, organizues dhe kontrollues i të gjithë veprimtarisë së drejtorisë dhe ushtron këto funksione:

- a) raporton dhe përgjigjet para këshillit administrativ;
- b) përfaqëson drejtorinë në marrëdhënie me të tretët;
- c) ndjek realizimin, treguesit tekniko-ekonomikë të spitalit;
- ç) përfaqëson drejtorinë në marrëdhënie me punonjësit, sipas Kodit të Punës;
- d) përgatit planet e punës në fillim të vitit dhe ia paraqet këshillit administrativ për miratim;
- dh) organizon kontrole për veprimtarinë e shërbimeve mjekësore dhe jomjekësore në spitale dhe merr vendimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes;
- e) drejton punën për hartimin e projektbuxhetit ekonomik dhe financiar dhe i paraqet për miratim këshillit administrativ buxhetin e zëbërthyer për çdo spital, shërbim e repart;
- ë) kontrollon punën dhe përgjigjet për realizimin e buxhetit;
- f) ndjek zbatimin e vendimeve të stafit të drejtorisë për kualifikimin dhe specializimin e kuadrit të lartë dhe të mesëm;
- g) miraton rregulloren për funksionimin e komisionit mjekësor.

#### Neni 20

##### **Komisioni mjekësor**

1. Komisioni mjekësor është organ këshillimi teknik i drejtorisë dhe përbëhet nga drejtorët e spitaleve, që funksionojnë brenda autoritetit spitalor të qarkut dhe shefat e shërbimeve ose përfaqësues të zgjedhur nga vetë shërbimet e këtyre spitaleve.

2. Komisioni mjekësor kryesohet nga kryetari i zgjedhur me votim të fshehtë, në bazë të kriterëve të vendosura nga Ministri i Shëndetësisë dhe ushtron veprimtarinë e tij për tre vjet.

#### Neni 21

##### **Funksionet e komisionit mjekësor**

Komisioni mjekësor i propozon drejtorisë së autoritetit spitalor të qarkut:

- a) blerjen e pajisjeve mjekësore, diagnostike dhe terapeutike;
- b) vendimet, që përfshijnë aspektet mjekësore të punës;
- c) rregullat e organizimit të shërbimeve mjekësore të institucionit;
- ç) vlerësimin, krijimin, mbylljen ose modifikimin e reparteve, spitaleve ose të gjitha njësive funksionale në varësi;
- d) vlerësimin e treguesit cilësor të shërbimeve;
- dh) zbatimin e protokolleve të mjekimit;
- e) trajnimin e personelit mjekësor dhe atij ndihmës;
- ë) shërbimet dhe pajisjet e reja.

#### Neni 22

##### **Mbikëqyrja dhe kontrolli**

1. Ministria e Shëndetësisë, duke respektuar detyrat dhe përgjegjësitë e autoritetit spitalor të qarkut, ushtron mbikëqyrje dhe kontroll mbi autoritetin spitalor të qarkut për cilësinë e shërbimeve dhe zbatimin e standardeve në spitale, si dhe kontroll ekonomik-financiar për pjesën e buxhetit që financon.

2. Ministria e Shëndetësisë ushtron kontroll mbi institucionet e tjera jopublike dhe jofitimprurëse të stafit menaxhues të tyre vetëm për kushtet e higjienës dhe përmbushjes së standardeve mjekësore.

3. Kontrolli mbi kontratat me institucionet e ndryshme dhe mbi marrëveshjet me sigurimet shoqërore, ushtrohet sipas detyrimeve të përcaktuara në vetë kontratat ose marrëveshjet.

### KREU III SPITALET PUBLIKE

#### Neni 23

1. Spitalet publike janë institucione me buxhet të pavarur, jofitimprurëse dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mjediset dhe me pajisjet që janë pronë e Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Ministri i Shëndetësisë përcakton organizimin, strukturën dhe rregulloret e funksionimit të spitaleve publike.

#### Neni 24

##### **Financimi i spitaleve**

Spitalet publike financohen nga:

- a) Ministria e Shëndetësisë;
- b) institucionet e sigurimeve shëndetësore;
- c) pushteti vendor;
- ç) donatorët vendas e të huaj.

#### Neni 25

Spitalet jopublike kanë burimet e veta të financimit, të përcaktuara në statutin, aktin e themelimit dhe vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik.

#### Neni 26

Spitalet publike dhe jopublike mund të shesin shërbimin e tyre në institucionet e sigurimeve shëndetësore të Republikës së Shqipërisë dhe të shteteve të huaja.

#### Neni 27

Spitalet publike, për shërbimet që ofrojnë, zbatojnë tarifat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 28

Format e financimit të veprimtarisë së spitaleve publike janë:

- a) pagesa me buxhetin;
- b) pagesa për banorë;
- c) pagesa për shërbim;
- ç) pagesa për rast;
- d) pagesa për grupe diagnozash të njëjta.

#### Neni 29

Spitalet e zhvillojnë veprimarinë e tyre financiare, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për institucionet me buxhet të pavarur.

#### Neni 30

Spitalet publike raportojnë, në fund të vitit financiar, te Ministria e Shëndetësisë, institucionet e sigurimeve shëndetësore dhe te çdo institucion tjetër, që ka kontribuar me fonde për zhvillimin e

veprimtarisë së tyre.

## KREU IV KËRKESAT DHE KLASIFIKIMI I SPITALEVE

### Neni 31

Ministri i Shëndetësisë njeh, hap, klasifikon dhe licencon spitalet publike dhe jopublike, në varësi të përmbushjes së kushteve, arritjes së standardeve, në bazë të teknologjisë spitalore dhe shkallës së plotësisë të kërkesave të domosdoshme për:

a) shërbimet e kualifikuara në njësitë e pranimit të urgjencës, për nivelin e realizimit të higjienës personale të të sëmurëve, të mjediseve spitalore, si dhe kapacitetet e teknologjisë së përshtatshme në shërbim të mbikëqyrjes së të sëmurëve;

b) sigurimin e mjediseve të përshtatshme për shtrime, që i përgjigjen natyrës së veçantë të shërbimit, të seksit dhe të moshës së të sëmurëve;

c) mjedise të veçanta për izolimin dhe kujdesin e të sëmurëve me sëmundje ngjithëse;

ç) shërbime të veçanta të radiologjisë dhe analizave laboratorike;

d) shërbime të veçanta për transfuzionin e gjakut dhe anestezinë;

dh) shërbimet bibliotekare dhe pajisjet e sallës së konferencave të mjekëve;

e) shërbimet e dezinfektimit, lavanderisë, garderobës, banjës, kuzhinës dhe magazinimit;

ë) shërbimet e ndihmës së shpejtë me ekupe të kualifikuara, me instrumente e pajisje të nevojshme, si dhe me mjetet e duhura të transportit;

f) mjedise për këshillime ambulatorie për kontrollin dhe kurimin e të sëmurëve edhe pas daljes nga spitali, ushtrimin e mjekësisë parandaluese dhe edukimin shëndetësor;

g) logjistikën dhe pajisjet e duhura të repartit të morgut dhe të sallës së autopsisë;

gj) trajtimin dhe eliminimin e mbeturinave spitalore, në përputhje me rregullat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 32

#### **Kategoritë e spitaleve**

1. Spitalet publike janë të përgjithshme dhe të specializuara.

2. Spitalet e përgjithshme ofrojnë shtrim dhe kujdesje ndaj të sëmurëve në repartet e mjekësisë së përgjithshme, kirurgjisë së përgjithshme dhe ato speciale.

3. Spitalet e specializuara ofrojnë shtrim dhe kujdesje ndaj të sëmurëve me sëmundje, që bëjnë pjesë në një ose më shumë specialitete.

4. Për specialitetet që krijohen për herë të parë, emërtimi i spitalit bëhet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

### Neni 33

Spitalet klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

a) spitale ditore;

b) spitale në nivel bashkie;

c) spitale qarku;

ç) spitale terciare.

### Neni 34

#### Spitalet ditore

Spitalet ditore publike dhe jopublike ofrojnë ndihmën e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.

Neni 35

**Spitalet publike në nivel bashkie**

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë shërbimet:

- a) e urgjencës;
- b) e mjekësisë së përgjithshme;
- c) e kirurgjisë së përgjithshme;
- ç) e pediatriisë dhe obstetrikë-gjinekologjisë;
- d) e radiologjisë;
- dh) e laboratorëve kliniko-biokimikë;
- e) e njësisë së anestezi-reanimacionit;
- ë) e farmacisë.

Neni 36

**Spitalet publike të qarkut**

1. Spitalet publike të qarkut ofrojnë shërbimet:

- a) e urgjencës;
- b) e mjekësisë së përgjithshme;
- c) e kirurgjisë së përgjithshme, ortopedi-traumatologji;
- ç) e obstetrikë-gjinekologjisë;
- d) e pediatriisë;
- dh) e radiologjisë;
- e) e fizioterapisë;
- ë) e anatomisë dhe histologjisë patologjike;
- f) e laboratorëve kliniko-biokimikë e të mikrobiologjisë;
- g) e anestezi-reanimacionit;
- gj) e farmacisë;
- h) e këshillimit ambulator, për të gjitha specialitetet e mësipërme.

2. Spitalet e qarkut janë të pajisura me klinika ose kabinete për:

- a) hemodializën;
- b) okulistikën;
- c) otorinolaringologjinë;
- ç) urologjinë;
- d) neurologjinë;
- dh) psikiatrinë;
- e) dermatologjinë;
- ë) onkologjinë.

3. Në spitalet e qarkut mund të funksionojnë edhe:

- a) shërbime riaftësimi dhe riedukimi funksional;
- b) shërbime të neuropsikiatriisë infantile;
- c) shërbime të dietologjisë;
- ç) shkollë-konvikt për infermierë dhe qendër për kualifikimin e personelit ndihmës dhe teknik.

Neni 37

**Spitale terciare**

1. Spitale terciare quhen spitalet me organizim teknik, pajisje mjekësore dhe me shërbime, që janë në gjendje të sigurojnë:

- a) ndihmë mjekësore të nivelit të lartë;
- b) punë kërkimore-shkencore, në bashkëpunim me departamentet e mësimdhënies;
- c) përgatitje profesionale për njohjen e personelit mjekësor me të rejtat e shkencës;
- ç) shkolla për kualifikimin e personelit ndihmës dhe teknik.

2. Spitalet terciare funksionojnë me status të veçantë, sipas përcaktimeve të bëra me vendim të

Këshillit të Ministrave.

3. Spitalet terciare financohen nga:

- a) Buxheti i Shtetit nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
- b) institucionet e sigurimeve shëndetësore;
- c) donatorët.

Neni 38

### **Spitalet e specializuara**

Emërtimi i spitaleve të specializuara bazohet në natyrën e veçantë të shërbimit e të specialitetit që ato ofrojnë.

KREU V

## **PLANIFIKIMI SPITALOR**

Neni 39

### **Komiteti Shtetëror për Planifikimin Spitalor**

1. Pranë Ministrit të Shëndetësisë ushtron veprimtarinë e vet, si një organ këshillimor, Komiteti Shtetëror për Planifikimin Spitalor.

2. Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit të këtij Komiteti përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 40

### **Komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut**

1. Pranë autoritetit spitalor publik të qarkut ushtron veprimtarinë e vet komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut, i cili është organi këshillimor i tij.

2. Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit të këtij komiteti përcaktohen me vendim të këshillit administrativ të autoritetit spitalor të qarkut.

Neni 41

### **Plani shtetëror spitalor**

1. Plani shtetëror spitalor miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të bërë nga Ministri i Shëndetësisë.

2. Plani shtetëror spitalor përcakton:

a) shpërndarjen sasiore dhe cilësore të numrit të shtretërve në nivel qarku, që do të mbahen me shpenzimet e shtetit;

b) kriteret territoriale dhe cilësore për përdorimin e fondit shtetëror spitalor;

c) nevojat për shtretër të rinj ose për pakësimin e tyre, si dhe për kërkesat didaktike dhe shkencore të universitetit;

ç) rindarjen e numrit të shtretërve, ndërmjet sektorëve të veprimtarisë spitalore dhe të niveleve të ndryshme organizativo-funksionale të rrjetit spitalor shtetëror;

d) rindarjen sasiore dhe cilësore të nevojës për shërbim spitalor;

dh) përqindjet që aplikohen mbi planin shtetëror dhe planin në nivel qarku, në bazë të rezultateve të kuadrit nozologjik, shtetëror e të gjithë përbërësve higjieniko-sanitarë, gjeomorfologjikë dhe socialë, ekonomikë e kulturorë, raportin ndërmjet numrit të shtretërve dhe popullatës së interesuar, si dhe shpërndarjes së numrit të shtretërve, duke mbajtur parasysh parashikimet e planeve urbanisike.

Neni 42

### **Plani spitalor në nivel qarku**

1. Autoriteti spitalor publik i qarkut programon ndërhyrjet e veta në sektorin spitalor, në

përputhje me planin shtetëror spitalor në fushën, në të cilën ky autoritet ka detyra dhe përgjegjësi territoriale.

2. Plani spitalor i qarkut miratohet nga këshilli administrativ, në përputhje me planin shtetëror spitalor, dhe përcakton parashikimin e ndërhyrjeve në qark të lidhura me ngritjen e spitaleve të reja, me transformimin, modernizimin ose mbylljen e spitaleve ekzistuese, me nevojën për një numër shtretërisht të ndarë për rastet akute, kronike, konvaleshente, me efikasitetin e pajisjeve, me rrjetin rrugor dhe kushtet gjeomorfologjike dhe higjieno-sanitare të popullatës.

3. Zgjerimi, transformimi, përveç përshtatjeve të detyruara nga kërkesa funksionale, duhet të realizohen, në përputhje me planin spitalor të qarkut.

4. Plani spitalor i qarkut parashikon ekzistencën:

a) e spitalit ditor, i cili të jetë në gjendje t'i shërbejë një popullatë nga 20 000 deri në 40 000 banorë;

b) e spitalit në nivel bashkie qendër rrethi, i cili të jetë në gjendje t'i shërbejë një popullatë mbi 100 000 banorë;

c) e spitalit të qarkut, i cili të jetë në gjendje t'i shërbejë një popullatë mbi 200 000 banorë.

5. Në planin spitalor të qarkut duhet të përcaktohen mjetet financiare për ndërtimin e spitaleve të reja, zgjerimin, transformimin ose modernizimin e atyre ekzistuese, blerjen e pajisjeve përkatëse, si dhe për shpërndarjen e tyre, në lidhje me objektivat e përcaktuara nga plani spitalor i qarkut.

## KREU VI SPITALET JOPUBLIKE

### Neni 43

1. Çdo person juridik, vendas ose i huaj, mund të ushtrojë veprimtari në fushën e shërbimit spitalor vetëm pas miratimit të lejes së lëshuar, sipas procedurave të parashikuara në dispozitat e këtij ligji.

2. Lejohet hapja e spitaleve jopublike të harmonizuara me planin spitalor shtetëror dhe vendor.

### Neni 44

#### **Procedura për hapjen e spitaleve jopublike**

1. Çdo person juridik, që ka për qëllim të hapë një spital jopublik, të zgjerojë ose të transformojë një spital jopublik ekzistues, duhet të paraqesë kërkesën pranë Komisionit të Licencave të Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Kërkesa duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) për veprimtarinë mjekësore që do të zhvillohet;

b) për kushtet higjieno-sanitare;

c) për numrin e shtretërve;

ç) për planimetrinë e mjediseve;

d) për rregulloren e funksionimit të spitalit.

### Neni 45

1. Komisioni i Licencave informon kryetarin e bashkisë ose të komunës, ku parashikohet të hapet spitali dhe shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin përkatës brenda 30 ditëve nga paraqitja e tyre. Brenda 5 ditëve nga miratimi i kërkesës, i propozon Ministrit të Shëndetësisë dhënien e licencës për hapjen e spitalit jopublik. Në rast refuzimi, Komisioni i Licencave i Ministrisë së Shëndetësisë është i detyruar t'i kthejë përgjigje zyrtare të interesuarit për arsyet e mosmiratimit të licencës për hapjen e spitalit jopublik.

2. E njëjta rrugë ndiqet edhe për kërkesat për zgjerimin dhe transformimin e spitaleve jopublike.

3. Modeli i licencës përcaktohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë në përputhje me standardet e bashkësisë europiane.

#### Neni 46

1. Në rastin e mosplotësimit të dispozitave të këtij ligji dhe të kushteve të vëna në aktin e lejes, spitali paralajmërohet për të shmangur shkeljet brenda një afati të përshtatshëm që përcaktohet në aktin e paralajmërimit.

2. Në rastin e shkeljeve të përsëritura të dispozitave të këtij ligji, Ministri i Shëndetësisë, me propozimin e Komisionit të Licencave, i heq licencën spitalit jopublik.

3. Heqjen e licencës së spitalit jopublik e bën Ministri i Shëndetësisë, bazuar në propozimin e Komisionit të Licencave. Ministri i Shëndetësisë nuk mund të heqë licencën e spitalit jopublik pa shqyrtuar argumentet e subjektit të licencuar.

#### Neni 47

1. Ministria e Shëndetësisë ka të drejtë të kontrollojë:

a) rregullat teknike të ndërtimit, kushtet, pajisjet dhe shërbimet, në përputhje me veprimtarinë që do të ushtrojë;

rregulloret e shërbimeve dhe curriculum vitae të personelit.

2. Emërtimi i spitaleve jopublike gjithmonë paraprihet ose përcaktohet me emërtimin "spital jopublik". Emërtimet që krijojnë keqkuptime me emërtimet e spitaleve ose të klinikave universitare publike, nuk mund të përdoren.

#### Neni 48

##### **Drejtori mjekësor**

1. Çdo spital jopublik, i cili ka më shumë se 50 shtretër, duhet të ketë një drejtor mjekësor me kohë të plotë pune, të cilit i ndalohet çdo veprimtari e ushtrimit të profesionit në spitale të tjera, qofshin këto publike ose jopublike.

2. Drejtori mjekësor përgjigjet personalisht për organizimin tekniko-funksional, për standardet dhe ecurinë e shërbimeve higjieno-sanitare.

3. Për çdo rast me sëmundje infektive, drejtori merr masat e nevojshme dhe bën denoncimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 49

Organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ose dëshirojnë të ofrojnë perkujdesje për të sëmurët, u lind e drejta e kërkesës pranë Ministrisë së Shëndetësisë, për miratimin e kësaj veprimtarie.

#### Neni 50

Spitalet publike dhe jopublike dëmshpërblejnë të sëmurin e dëmtuar, sipas Kodit Civil, kur dëmtimi ka ardhur nga mosrespektimi i rregullave gjatë ushtrimit të detyrës nga personeli mjekësor ose mosdhënia në kohë e ndihmës urgjente mjekësore, sipas nenit 6 të këtij ligji.

#### Neni 51

1. Shkelja e nenit 6 të këtij ligji nga personeli mjekësor, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në vlerën e dy pagave mujore. Kjo masë merret me vendim të drejtuesit të institucionit përkatës.

2. Procedurat për vënien e gjobës dhe ankimin rregullohen nga ligji nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 52

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 6, 18, 37, 39 dhe 41.

2. Ngarkohet Ministri e Shëndetësisë që, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, 23, 31, 45 dhe 47.

Neni 53

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3920, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**L I G J**

**Nr.9107, datë 17.7.2003**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8636, DATË 6.7.2000 "PËR ZONAT E LIRA",  
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8725, DATË 26.12.2000**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 8636, datë 6.7.2000 "Për zonat e lira", ndryshuar me ligjin nr.8725, datë 26.12.2000 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pikat 1 dhe 2 të nenit 4 ndryshohen si më poshtë:

"1. Në bazë të studimeve rajonale dhe të zhvillimit ekonomik të vendit, Enti, i mbështetur në vendimin e këshillit drejtues, i paraqet ministrit që mbulon ekonominë propozimin për krijimin e një zone të lirë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon ekonominë miraton rast pas

rasti shpalljen e një zone të lirë."

## Neni 2

Pika 4 e nenit 6 ndryshohet si më poshtë:

"4.Enti është institucion qendror, në varësi të ministrit që mbulon ekonominë."

## Neni 3

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

## "Neni 7

1. Këshilli drejtues i Entit përbëhet nga 7 anëtarë dhe kryesohet nga ministri që mbulon ekonominë. Drejtori ekzekutiv emërohet nga ministri që mbulon ekonominë.

2. Këshilli drejtues përbëhet nga:

- a) zëvendësministri që mbulon ekonominë;
- b) zëvendësministri që mbulon financat;
- c) zëvendësministri që mbulon veprimtarinë e industrisë;
- ç) Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;
- d) Kryetari i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
- dh) Drejtori Ekzekutiv i Entit Kombëtar të Zonave të Lira."

## Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3921, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

## **SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM**

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të tokës me sipërfaqe 650 m2 në Bashkinë Ballsh, me pronar z.Hajri Malaj dhe z. Zihni Çela.

Subjekti kërkues është Bashkia e Ballshit. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni, personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni ka të bëjë me sipërfaqen që shpronësohet 650 m2 dhe masën e vlerësimit të sipërfaqes sipas çmimit 1489.6 lekë/m2.

### **LISTA EMËRORE E PERSONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REHABILITIMIN E TERRITOREVE TË GJELBRA NË BASHKINË BALLSH**

| Nr. | Emri, atësia, mbiemri | Sipërfaqja m2 | Çmimi lekë/m2 | Vlera në lekë |
|-----|-----------------------|---------------|---------------|---------------|
| 1   | Hajri Malaj           | 202           | 1489 6        | 300 899       |
| 2   | Zihni Çela            | 448           | 1489 6        | 667 340       |
|     | Shuma                 | 650           | 1489 6        | 968 240       |

## **SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM**

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për ndërtimin e Urës së Re Bogovë.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur

nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të jetë për një periudhë një javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrat në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Sektorin e Shpronësimeve në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

| Nr. | Emri   | Atësia  | Mbiemri    | Nr/pasurisë | Objekt             | Çmimi<br>lekë/m2 | Vlera<br>lekë | Shënime |
|-----|--------|---------|------------|-------------|--------------------|------------------|---------------|---------|
|     |        |         |            |             | Sip<br>shpronësuar |                  |               |         |
| 1   | Iljaz  | Hariz   | Hysko      | 305/3       | 40                 | 11358 5          | 453 340       |         |
| 2   | Bazat  | Celnik  | Hoxhallari | 310/8       | 60                 | 11358 5          | 681510        |         |
| 3   | Renato | Skënder | Çuni       | 301/53      | 160                | 3400000          | 3400000       |         |

Shënim: Brenda afatit ligjor 15 ditë pas publikimit pronarët të paraqesin çdo kërkesë që kanë pranë Sektorit të Shpronësimeve në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

|                                                                                                            |                                                                                                                                                   |                                                                                                                  |                                                                                                  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Kodi Penal</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Mars, 2002               | <b>Kodi i<br/>Procedurës Penale</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Shtator, 2002                                 | <b>Kodi i<br/>Procedurës Civile</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Korrik, 2002 | <b>Kodi Rrugor</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Qershor, 2002 |
| <b>Kodi Penal<br/>Ushtarak</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Tetor, 2002 | <b>Përmbledhëse<br/>legjislacioni<br/>në fushën<br/>e Përmbarimit</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Tetor, 2002 |                                                                                                                  |                                                                                                  |

Doli nga shtypi më 4.8.2003

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4300 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë